

UNMIK/DIR/2008/2  
17 janar 2008

---

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2008/2**

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2006/25 MBI  
KORNIZËN RREGULLATIVE PËR SISTEMIN E DREJTËSISË NË  
KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 2006/25 të datës 27 prill 2006 mbi kornizën rregullative të sistemit të drejtësisë në Kosovë,

Duke marrë parasysh nenet 9.4.6-8 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001 dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK),

Duke marrë parasysh emërimet me kohë të caktuar për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë, të cilëve u skadon mandati pas përfundimit të administratës së UNMIK-ut në Kosovë, apo varësisht si është vazhduar mandati me rregullore shtesë të shpallur nga PSSP-ja,

Duke ditur se procesi i emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të zgjasë edhe pas përfundimit të mandatit aktual të UNMIK-ut ashtu siç parashihet me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB 1244),

Me qëllim të vendosjes së dispozitave me të cilat do të udhëhiqet themelimi dhe veprimtaria e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) dhe Panelit për rishikim të KPGJP-së, në pajtim me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25, i cili do të shqyrtojë përshtatshmërinë e të gjithë aplikantëve për pozita gjyqësore dhe prokuroriale përmes një procesi gjithëpërfshirës mbarëkosovar të emërimit dhe riemërimit,

Duke siguruar që procesi i shqyrtimit të përshtatshmërisë së aplikantëve për pozita gjyqësore dhe prokuroriale të bëhet në mënyrë transparente dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut,

Nxjerr këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1  
Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial

1.1 Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) është themeluar si organ autonom i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut gjatë periudhës së mandatit të tij sipas RKSKB 1244, me qëllim të drejtimit të një shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar të përshtatshmërisë së të gjithë aplikantëve për emërim të përhershme, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë (“Procesi i emërimit”). Në përfundim të këtij procesi, rekrutimi dhe përzgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë do të bëhet në pajtim me të gjitha ligjet tjera në fuqi.

1.2 KPGJP-ja do të përdorë emrin dhe vulën e IGJK-së.

1.3 Mandati i KPGJP-së përfundon kur përfundon procesi i emërimit.

1.4 Gjatë fazës së parë të procesit të emërimit, KPGJP-ja do të përbëhet nga 5 anëtarë ndërkombëtarë, të cilët do të jenë gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë të caktuar në KGJK nga PSSP-ja, vetëm për të shërbyer në KPGJP për një kohë të caktuar, ndërmjet skadimit të mandatit të pesë anëtarëve gjyqësor kosovarë aktual të KGJK-së dhe caktimit të anëtarëve gjyqësor të cilët verifikohen nga KPGJP-ja në pajtim me këtë Urdhëresë administrative. Anëtarët ndërkombëtarë të caktuar për të shërbyer në KPGJP mund të shërbejnë me kontratë me gjysmë orari apo orar të plotë ose me rotacion. Pjesën tjetër të anëtarësimit të KGJK-së do ta përbëjnë katër anëtarë jogjyqësor të caktuar sipas detyrës zyrtare, një gjyqtar dhe një prokurorë ndërkombëtar.

1.5 Vetëm anëtarët e KPGJP-së do të kenë kompetenca që të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t’u emëruar si gjyqtar dhe prokuror në procesin e emërimit. PSSP-ja do të caktojë anëtarë ndërkombëtarë në numër të mjaftueshëm për të siguruar që KPGJP-ja të konstituohet në mënyrën e duhur.

1.6 Mandati dhe përbërja e KPGJP-së nuk do të ndikohet nga themelimi i cilitdo subjekti përgjegjës për të këshilluar PSSP-në mbi çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, disiplinën dhe shkarkimin e prokurorëve, siç është Këshilli Prokurorial i Kosovës.

2.1 KGJK-ja do të bëjë ftesë, përmes shpalljes publike, për paraqitjen e aplikacioneve nga gjyqtarët dhe prokurorët në shërbim dhe nga profesionistët ligjorë që të shërbejnë si gjyqtarë dhe prokurorë në të gjitha pozitat gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë. Shpallja publike do të përfshijë të gjitha informacionet lidhur me numrin dhe llojin e pozitave dhe kushteve për çdo pozitë, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/52 si dhe procedurën për dorëzimin e aplikacionit. Shpallja publike nuk vlen për pozitat e gjyqtarëve laikë dhe për personelin përgjegjës për administrimin e gjykatave dhe prokurorive.

2.2 Procesi i emërimit fillon me shpalljen e vendeve të lira nga KGJK-ja në emër të KPGJP-së dhe përfundon kur të përfundojnë veprimet e ndërmarra nga PSSP-ja apo nga institucionet kompetente kosovare pas UNMIK-ut për të gjitha emërimet. Mandati i KPGJP-së do të përfundojë pas përfundimit të procesit të emërimit.

2.3 Procesi i emërimit do të organi zohet në tri faza të njëpasnjëshme:

(a) Faza 1 – Përzgjedhja e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme të Kosovës dhe e prokurorëve publikë për prokuroritë publik të Kosovës, duke përfshirë edhe prokurorinë speciale të Kosovës.

(b) Faza 2 – Përzgjedhja e gjyqtarëve për gjykatat e qarkut, për Gjykatën ekonomike dhe për Gjykatën e lartë për kundërvajtje dhe e prokurorëve publik për prokuroritë publike të qarkut.

(c) Faza 3 - Përzgjedhja e gjyqtarëve për gjykatat komunale dhe për gjykatat komunale për kundërvajtje dhe e prokurorëve publikë për prokuroritë publike komunale.

2.4 Me përjashtim të provimit pranues gjyqësor, kandidatët për pozita gjyqësore apo prokuroriale duhet t'i plotësojnë kushtet për pozitën specifike për të cilën kanë aplikuar jo më vonë se data e skadimit të shpalljes publike.

2.5 KPGJP-ja, duke punuar në panele të vlerësimit me tre anëtarë secili, i shqyrton të gjitha aplikacionet për pozita gjyqësore dhe prokuroriale të cilat i plotësojnë kriteret e shënuara në shpalljen publike.

2.6 KPGJP-ja e njofton kandidatin me shkrim nëse ai nuk ka të drejtë për t'u emëruar për shkak se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në shpalljen publike.

2.7 KPGJP-ja do të nxjerrë rregulla për drejtimin, themelimin, përbërjen dhe funksionimin e paneleve të vlerësimit.

2.8 Anëtarët e KPGJP-së do të zbatojnë kriteret të njëjta në vlerësimin e aplikantëve dhe shqyrtimin e tyre do ta bazojnë në materialet që i kanë në dosjet e secilit si dhe në intervistën për t'iu mundësuar të bëjnë vlerësimin e punës

profesionale të kandidatit. Në dosje përfshihet fletaplikacioni i tij i verifikuar, informacione të detajuara të biografisë dhe, sipas nenit 4, çfarëdo informacioni shtesë që kandidati dëshiron ta ofrojë lidhur me këtë pas shqyrtimit të dosjes. Do të intervistohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret për emërim.

2.9 Gjatë intervistës do të shtrohen pyetje standarde dhe do të përdoret një formular i standardizuar për vlerësimin e kandidatëve.

2.10 Gjyqtarët dhe prokurorët në shërbim nuk duhet t'i nënshtrohen provimit gjyqësor pranues. Mirëpo, KPGJP-ja mund të kërkojë, në raste individuale, që gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë duke punuar që kanë aplikuar për riemërim t'i nënshtrohen provimit me shkrim të paraparë në nenin 3.4, nëse paneli për vlerësim nuk mund të vendosë për aplikacionin e kandidatit në bazë të dokumenteve të paraqitura në dosjen e tij dhe të intervistës, ose për ndonjë arsye tjetër kur nevojiten informacione shtesë për njohuritë ligjore dhe aftësitë e kandidatit.

2.11 Të gjithë kandidatët, pa përjashtim, duhet të kalojnë provimin mbi Kodin relevant të etikës.

2.12 Pas vlerësimit të detajuar dhe intervistës së çdo kandidati që ka të drejtë për emërim, paneli për vlerësim voton për çdo aplikacion dhe vendimi i panelit vlerësues do t'i paraqitet në tërësi KPGJP-së për veprime të mëtejme. Paneli vlerësues i dorëzon një vendim të shkurtër në tërësi KPGJP-së për të shpjeguar arsyet për votën e tij për çdo kandidat. Dosjet e kandidatëve të cilët marrin miratimin e njëzëshëm nga paneli për vlerësim i dorëzohen pa vonesë KGJK-së për t'ia dërguar PSSP-së me rekomandim për të bërë emërimet. KPGJP-ja në përbërje të plotë voton për çdo kandidat që merr vota të ndara nga paneli vlerësues, dhe kandidatët të cilët kalojnë me shumicë të thjeshtë do t'i dërgohen KGJK-së për t'i dorëzuar PSSP-së me rekomandim për të bërë emërimet. KPGJP-ja në përbërje të plotë mund të kërkojë shpjegime apo të dhëna shtesë nga paneli për vlerësim para dërgimit të dosjeve të kandidatëve në KGJK. KPGJP-ja gjithashtu do të përzgjedhë për emërim kryetarë gjykatash dhe kryeprokurorë për çdo gjykatë dhe prokurori.

2.13 KPGJP-ja do t'i bëjë rekomandime me shkrim KGJK-së duke shënuar arsyet për vendimin mbi kandidatët për çdo gjykatë dhe prokurori në Kosovë për t'ia dërguar PSSP-së, në pajtim me dispozitat përkatëse të Kornizës Kushtetuese.

2.14 Në mungesë të një kandidati të përshtatshëm, KGJK-ja mund të vendosë që të ripublikojë shpalljen publike për një pozitë gjyqësore apo prokuroriale.

2.15 PSSP-ja ushtron pushtetin suprem gjatë emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke marrë parasysh rekomandimet e KGJK-së sipas nenit 2.7 të këtij Udhëzimi administrativ. Referenca në pushtetin dhe kompetencat e PSSP-së në këtë Udhëzim administrativ do të interpretohet ashtu që të nënkuptojë PSSP-në apo pasardhësin kompetent, qoftë zyrtar apo institucion që do të ushtrojë pushtetin dhe kompetencat e tilla kur këto të mos ushtrohen më nga PSSP-ja.

2.16 Gjyqtarët dhe prokurorët në shërbim të cilët nuk janë riemëruar, qofshin ata që kanë aplikuar për riemërim apo jo, do ta përfundojnë punësimin e tyre në ditën kur të fillojnë punën gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar në këto pozita për të cilat kanë qenë të ngarkuar gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk janë riemëruar.

2.17 Sekretariati i KPGJP-së e njofton kandidatin me shkrim mbi vendimet që i kanë marrë për aplikacionet e tyre.

2.18 Nëse pasi që të merret vendimi përfundimtar mbi emërimin, KGJK-ja merr informacione lidhur me kandidatin, të cilat informacione po të ishin bërë të ditura në kohën e emërimit të kandidatit në fjalë do të rezultonin me mosrekomandimin e KPGJP-së që të emërohet kandidati i tillë, KPGJP-ja do të fillojë procesin e jashtëzakonshëm për rishqyrtim në pajtim me procedurat e parapara në nenin 6 të kësaj Urdhërese administrative. Këtë të drejtë të tërheqjes KPGJP-ja do ta ketë në dispozicion deri pas dy muajsh pas përfundimit formal të procesit të emërimit në pajtim me nenin 2.2 të kësaj Urdhërese administrative.

2.19 Nëse PSSP-ja nuk pranon dhe vepron në bazë të rekomandimit për emërim nga KGJK-ja, KGJK-ja do të njoftohet dhe KGJK-ja ose do të rekomandojë emërimin e një kandidati tjetër nga radhët e aplikantëve ose do ta ripublikojë pozitën si të lirë.

### Neni 3

#### Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për të shërbyer si gjyqtarë apo prokurorë

3.1 Përveç nëse është paraparë ndryshe, gjatë procesit të emërimit do të zbatohen kriteret e parapara në nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 edhe për gjyqtarët edhe për prokurorët.

3.2 Gjatë dhënies së rekomandimeve për emërim dhe riemërim të kandidatëve, KPGJP-ja gjithashtu do të merr parasysh, mes tjerash, kriteret vijuese:

(a) Njohuritë profesionale, përvojën e punës dhe efektshmërinë, duke përfshirë edhe kuptimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

(b) Aftësinë për arsyetime ligjore të dëshmuar përmes aktiviteteve profesionale në fushën ligjore, si gjyqtarë dhe prokurorë publikë, punime të shkruara akademike, aktivitete të tjera profesionale dhe aftësitë gjatë rrjedhës së intervistës;

(c) Aftësinë profesionale të bazuar në rezultatet e karrierës së mëparshme, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në format e organizuara të trajnimit ku është vlerësuar efektshmëria;

(d) Aftësinë dhe zotësinë për analizimin e problemeve ligjore;

(e) Aftësinë për të kryer detyrat e pozitës për të cilën ai është marrë në konsiderim në mënyrë të paanshme, me vetëdije, në mënyrë të kujdesshme, bindëse dhe me përgjegjësi;

(f) Aftësinë e komunikimit;

(g) Marrëdhëniet me kolegët, sjelljen jashtë zyrës dhe integritetin dhe

(h) Përvojën menaxheriale dhe kualifikimet lidhur me pozitat e kryetarit të gjykatës dhe kryeprokurorit.

3.3 Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve individuale, anëtarët e KPGJP-së në veçanti do të udhëhiqen nga parimet e parapara në nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25, dhe çfarëdo kushtesh që vlejné lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës. KPGJP-ja gjithashtu do të ketë si objektivë arritjen e parimeve të njohura ndërkombëtarisht mbi barazinë gjinore.

3.4 Në pajtim me nenin 6.1 (f) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52, KPGJP-ja do të organizojë, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, provimin pranues për kandidatët gjyqësor dhe prokurorial. Të gjithë aplikantët duhet ta kalojnë këtë provim, përveç rasteve të parapara në nenin 2.10. Nëse provimi pranues gjyqësor organizohet apo rezultatet e tij shpallen pas datës së skadimit të shpalljes publike, kandidati nga i cili kërkohet që t'i nënshtrohet provimit do të dorëzojë aplikacionin ku do të shënojë qëllimin e tij për t'iu nënshtruar provimit pranues gjyqësor.

3.5 Aplikantët të cilët nuk e kalojnë provimin pranues gjyqësor nuk kanë të drejtë të merren në konsideratë për emërim.

3.6 Gjyqtarët apo prokurorët, të cilët përkohësisht janë të liruar nga provimi pranues gjyqësor në pajtim me nenin 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues gjyqësor të paraparë sipas këtij neni. Gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk e kalojnë provimin pranues gjyqësor do të shkarkohen nga pozitat e tyre në ditën kur fillojnë punën gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar në këto pozita.

#### Neni 4

#### Të drejtat e kandidatëve

4.1 Sipas nenit 4.2, kandidatët kanë të drejtë të kontrollojnë të gjitha materialet që i janë ofruar KPGJP-së lidhur me aplikacionet e tyre, të kërkojnë dhe të marrin informacione përmes KPGJP-së lidhur me aplikacionin dhe procesin e emërimit, të rishikojnë dhe të komentojnë për cilindo mendim apo informacion lidhur me aplikantin apo ndonjë çështje tjetër që ndikon në aplikacionin e tij dorëzuar KPGJP-së, dhe të ofrojnë informacione shtesë që mund të ndihmojnë KPGJP në vlerësimin e

aplikacionit të tij. E drejta për të pasur qasje dhe për të shqyrtuar materialet duhet të ofrohet para intervistës që kandidatit t'i lejohet kohë e mjaftueshme, nëse ka nevojë, që të përgatisë dhe të paraqesë përgjigje me shkrim apo me gojë.

4.2 Aplikantit i shpalosen informacionet që kanë të bëjnë me atë sa më tërësisht që të jetë e mundshme, përveç nëse nevojitet shpalosje në mënyrë të përmbledhur për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta apo për t'iu shmangur paragjyqimeve të hetimit penal apo procesit tjetër gjyqësor.

#### Neni 5

##### Ankesat ndaj kandidatëve

Ankesat ndaj të gjithë kandidatëve, qofshin gjyqtarë dhe prokurorë në shërbim apo ndonjë kandidat tjetër, dhe qofshin ata që presin për t'u dorëzuar apo janë dorëzuar para afatit i cili mbetet të përcaktohet, do të pranohen dhe hetohen nga Njësia e hetimeve gjyqësore në Departamentin e gjyqësisë të UNMIK-ut (DD/NJHGJ) apo nga pasardhësi i saj. Për kohëzgjatjen e procesit të emërimit, DD/NJHGJ do t'i paraqesë raport të plotë KPGJP-së ku do të përfshihen rezultatet e hetimeve të saj në rastet kur DD/NJHGJ ka gjetur dëshmi të keqsjelljes nga ana e një aplikantit. Në rastet kur DD/NJHGJ heton një ankesë ndaj aplikantit dhe nuk konstaton keqsjellje, atëherë vetëm KPGJP-së i dorëzon vendim me shkrim me të cilin konfirmon hedhjen poshtë të ankesës. Sipas nenit 4.2, këto informacione duhet të jenë pjesë integrale e dosjes së aplikantit dhe të jenë të hapura për shqyrtim nga kandidati.

#### Neni 6

##### Kërkesa për rishqyrtim

6.1 Kandidati i cili nuk i plotëson kushtet për të pasur të drejtë për emërim dhe nuk është përzgjedhur për pozita gjyqësore apo prokurori publike sipas këtij procesi të emërimit mund të paraqesë kërkesë në panelin për shqyrtim të Komisionit të pavarur gjyqësor dhe prokurorial ("Paneli për shqyrtim i KPGJP") brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga njoftimi mbi vendimin e tillë nga KPGJP, për rishqyrtim të vendimit.

6.2 Kërkesa për rishqyrtim të një vendimi mund të bëhet në bazë të arsyeve vijuese:

- (a) Vendimi i KPGJP-së është bazuar në gabime materiale ose mospërfshirje;
- (b) Ekzistojnë informacione të reja të rëndësishme, që kandidati më parë nuk i ka pasur në dispozicion apo nuk i ka ditur, të cilat po t'i kishte pasur në dispozicion në kohën kur KPGJP-ja e ka marrë vendimin, do të rezultonte me marrjen e një vendimi tjetër nga KPGJP ose

- (c) KPGJP-ja ka bërë gabim të rëndë procedural gjatë zbatimit të dispozitave të këtij Udhëzimi administrativ apo ato nuk i ka marrë parasysh.

6.3 Paneli për shqyrtim i KPGJP-së është themeluar si organi i pavarur dhe autonom i KPGJP-së me qëllim të vendosjes mbi kërkesat e paraqitura për rishqyrtim të vendimeve që i ka marrë KPGJP-ja.

6.4 Mandati i panelit për shqyrtim i KPGJP-së përfundon kur të përfundohet procesi i emërimit.

6.5 Gjatë kohëzgjatjes së fazës 1 të procesit të emërimit paneli për shqyrtim i KPGJP-së do të përbëhet nga tre anëtarë ndërkombëtarë, të cilët do të jenë ekspert të kualifikuar ligjor në çështje gjyqësore, të emëruar në KGJK nga PSSP-ja vetëm për të shërbyer në panelin për shqyrtim të KPGJP-së. Anëtarët ndërkombëtarë të cilët janë caktuar që të shërbejnë si anëtarë të panelit për shqyrtim të KPGJP mund të shërbejnë me kontratë me gjysmë orari apo me orar të plotë apo me rotacion. PSSP-ja do të emërojë anëtarë ndërkombëtarë në numër të mjaftueshëm për të siguruar që paneli për shqyrtim i KPGJP-së të mund të konstituohet në mënyrën e duhur.

6.6 Gjatë fazës 2 dhe fazës 3 të procesit të emërimit, paneli për shqyrtim i KPGJP-së do të përbëhet nga tre anëtarë të cilët do të jenë anëtarë ndërkombëtarë, të caktuar në KGJK nga PSSP-ja për fazën 1 të procesit të emërimit, ose anëtarë kosovarë të gjyqësisë, të cilët janë verifikuar dhe caktuar në procesin e emërimit.

6.7 PSSP-ja mund të caktojë anëtarë ndërkombëtarë shtesë me kualifikime përkatëse në KGJK me qëllim që ata të shërbejnë në panelin e KPGJP-së/paneli për shqyrtim.

6.8 Anëtarëve kosovarë në panelin për shqyrtim të KPGJP-së mund t'iu jepet kompensimi përkatës për shpenzimet e bëra në mënyrë të arsyeshme si rezultat i shërbimit të tyre në procesin e emërimit. Kompensimi do të përfshijë vetëm: mëditjet, transportin dhe shpenzimet e akomodimit.

6.9 Anëtarët e panelit për shqyrtim të KPGJP-së paraqesin menjëherë çfarëdo konflikti të interesit gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre dhe tërhiqen nga pjesëmarrja në cilindo panel që ka të bëjë me cilëndo çështje që lidhet me konfliktin e tillë të interesit.

6.10 Paneli për shqyrtim i KPGJP-së miraton rregulloren e punës.

6.11 Kuorumin e panelit për shqyrtim të KPGJP-së e përbëjnë tri anëtarë.

6.12 Vendimi i panelit për shqyrtim i KPGJP-së merret me shumicën e thjeshtë të votave.



6.13 Paneli për shqyrtim i KPGJP-së nxjerr vendim me të cilin e pranon ose e refuzon kërkesën për rishqyrtim.

6.14 Për vendimin e tij paneli për shqyrtim i KPGJP-së jep arsyet me shkrim.

6.15 Vendimet e panelit për shqyrtim të KPGJP-së janë të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit nga asnjë autoritet tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.

6.16 Kërkesa për rishqyrtim të një vendimi nga paneli për shqyrtim i KPGJP-së nuk e pezullon implementimin e emërimit në bazë të vendimeve të marra nga KPGJP-ja.

## Neni 7 Përbërja

7.1 Përbërja e KPGJP-së do të ndryshojë dhe do të rritet gradualisht në numër në pajtim me tri (3) fazat për emërim të identifikuar sipas nenit 2.3. Anëtarët e KPGJP-së do të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre. Në punën e KPGJP-së do të marrin pjesë vetëm anëtarët ndërkombëtarë të caktuar nga PSSP-ja dhe anëtarët e KGJK-së të emëruar pasi të jenë verifikuar në këtë proces.

7.2 Në fazën 1, për përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme të Kosovës dhe të prokurorëve për Prokurorinë publike të Kosovës, duke përfshirë edhe Prokurorinë speciale të Kosovës, KPGJP-ja do të ketë pesë anëtarë të cilët janë anëtarë ndërkombëtarë.

7.3 Në fazën 2, për përzgjedhjen e gjyqtarëve për gjykatat e qarkut, për Gjykatën ekonomike dhe Gjykatën e lartë për kundërvajtje dhe të prokurorëve për prokuroritë publike të qarkut, dy (2) gjyqtarë të caktuar në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe një (1) prokuror i caktuar në Prokurorinë publike të Kosovës gjatë fazës 1 do të caktohen si anëtarë edhe në KGJK edhe në KPGJP. Tre anëtarët ndërkombëtarë në KPGJP, të cilët zëvendësohen nga kosovarët e caktuar në KGJK do të vazhdojnë të shërbejnë në KPGJP deri në skadim të kontratës së tyre, dhe KPGJP, në këtë rast, mund të ketë deri më tetë (8) anëtarë gjatë fazës së dytë.

7.4 Në fazën 3, për përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat komunale dhe në gjykatat komunale për kundërvajtje dhe të prokurorëve për prokuroritë publike komunale, një (1) gjyqtar i caktuar në gjykatën e qarkut dhe një (1) prokuror i caktuar në prokurorinë publike të qarkut do të caktohen si anëtarë të KGJK-së dhe të KPGJP-së gjatë fazës 2. KPGJP-ja, në këtë rast, mund të ketë dhjetë (10) anëtarë për këtë raund të emërimeve.

7.5 Anëtarët e KGJK-së, të KPGJP-së dhe të panelit për shqyrtim të KPGJP-së do të emërohen nga PSSP-ja. Gjatë shqyrtimit të emërimeve sipas neneve 7.3 dhe 7.4, KPGJP-ja do t'ia rekomandojë kandidatët e përzgjedhur PSSP-së. Së paku një (1)

anëtar kosovar i KPGJP-së do të jetë përfaqësues i pakicave . Anëtarët e KGJK-së të caktuar sipas detyrës zyrtare nuk do të shërbejnë në KPGJP.

7.6 Anëtarët ndërkombëtarë të KPGJP-së do të emërohen për kohëzgjatjen e procesit të emërimit apo për kohëzgjatjen e kontratave të tyre të punës, varësisht se cila periudhë është më e shkurtër.

7.7 Kryetari i KPGJP-së do të caktohet nga PSSP-ja nga mesi i anëtarëve ndërkombëtarë. KPGJP-ja do ta zgjedhë nënkryetarin e tij, i cili do të kryej detyrat në vend të kryetari të KPGJP-së nëse ky i fundit përkohësisht mungon.

7.8 Gjyqtarët dhe prokurorët në shërbim në gjykatë apo në prokurori të caktuar si anëtarë të KGJK-së/ KPGJP-së apo anëtarë të panelit për shqyrtim të KPGJP-së do të marrin pushim nga gjykata e tyre apo prokuroria gjatë procesit të emërimit. Atyre ju ruhen të gjitha përfitimet dhe pagat.

7.9 Anëtarëve kosovarë të KPGJP-së dhe atyre në panelin për shqyrtim të KPGJP-së mund t'iu jepet kompensimi përkatës për shpenzimet që i kanë bërë në mënyrë të arsyeshme si rezultat i shërbimit të tyre në procesin e emërimit. Kompensimi do të përfshijë vetëm: mëditjen, transportin dhe shpenzimet e akomodimit.

### Neni 8

#### Kuorumi, votimi dhe mbledhjet

8.1 KPGJP-ja do t'i konvokojë mbledhjet ashtu siç kërkohet për të përmbushur mandatin e tij.

8.2 Gjatë fazës 1, katër (4) anëtarë të pranishëm në KPGJP përbëjnë kuorumin për mbledhje. Kryetari i KPGJP-së e hedh votën për të zgjidhur votat e barabarta.

8.3 Gjatë fazës 2 dhe 3, shtatë (7) anëtarë të KPGJP-së e përbëjnë kuorumin për mbledhje, përveç nëse parashihet ndryshe me Rregulloren e tij të punës. Kryetari i KPGJP-së e hedh votën për të zgjidhur votat e barabarta. Rregullorja e punës mund të lejojë një anëtar të KPGJP-së për t'ia besuar të drejtën e votës një anëtar tjetër të KPGJP në emër të tij.

8.4 Votimi merret me shumicën e thjeshtë të atyre të pranishëm.

### Neni 9

#### Tërheqja

Anëtarët e KPGJP-së deklarojnë menjëherë çfarëdo konflikti të interesit gjatë ekzekutimit të detyrave të tyre dhe tërhiqen nga pjesëmarrja në cilindo panel apo në sesionet plenare të KPGJP-së dhe të KGJK-së lidhur me cilëndo çështje që përfshin interesin e tillë të interesit.

Neni 10  
Sekretariati

10.1 KPGJP-së do t'i ndihmojë Sekretariati që të kryej punën e tij ("Sekretariati i KPGJP-së") i drejtuar nga një drejtor të emëruar nga PSSP-ja.

10.2 Drejtori është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të Sekretariatit, organizimin e tij dhe punësimin e punëtorëve. Drejtori mund të përfaqësojë KPGJP-në pranë palëve të treta.

Neni 11  
Qasja e autorizuar në të dhënat personale dhe konfidencialiteti

11.1 Qasje në të dhënat personale të kandidatëve mund të kenë vetëm anëtarët e KPGJP-së dhe stafi i Sekretariatit të KPGJP-së i autorizuar nga drejtori, me qëllim të arritjes së objektivave të KPGJP-së.

11.2 KPGJP-ja dhe Sekretariati i KPGJP-së do të ndërmarrin masat e nevojshme për të garantuar nivelin e mbrojtjes për të dhënat personale që së paku është i barasvlershëm me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve të Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin automatik të të dhënave personale të datës 28 janar 1981 dhe ndryshimeve të saj të mëpastajme.

11.3 Të gjitha dosjet dhe arkivat e KPGJP-së do t'i transferohen KGJK-së në fund të procesit të emërimit.

11.4 Anëtarët e KGJK-së, anëtarët e KPGJP-së dhe stafi i Sekretariatit të KPGJP-së do të përmbahen nga çdo deklaratë publike apo veprim që mund të ndikojë në integritetin e procesit të emërimit.

Neni 12  
Financimi

Me përjashtim të anëtarëve të KGJK-së dhe punëtorëve të tjerë që kanë ofruar mbështetje nga KGJK-ja apo nga UNMIK-u, KPGJP-ja, paneli për shqyrtim i KPGJP-së dhe Sekretariati i KPGJP-së do të financohen përmes granteve.

Neni 13  
Rregullorja e punës

13.1 KPGJP-ja do të miratojë Rregulloren e punës (Rregullorja e punës për procesin e emërimit) në mbledhjen e parë me shumicën e pesë (5) anëtarëve të saj fillestarë.

13.2 Rregullorja e punës do të parasheh punën, procedurat dhe organizimin e KPGJP-së.

13.3 Mbledhja e parë e KPGJP-së do të drejtohet përshtatshëmrisht (*mutatis mutandis*) me Rregulloren e punës së KGJK-së.

Neni 14  
Dispozitat kalimtare

14.1 Mandati i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve aktual në shërbim do të vazhdohet deri në ditën kur të fillojnë punën gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar si rezultat i procesit të emërimit, pa marrë parasysh moshën e detyrueshme për pensionim, që përkohësisht është pezulluar.

14.2 Mandati i gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë që aktualisht shërbejnë në KGJK vazhdohet deri në emërimin e anëtarëve të KPGJP-së.

14.3 Mandati i anëtarëve ndërkombëtarë të KGJK-së vazhdohet deri në fund të mandatit të UNMIK-ut.

Neni 15  
Dispozitat përfundimtare

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Urdhërese administrative, Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2006/18 dhe Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2007/7 do të revokohen.

Neni 16  
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 janar 2008.

Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm